



KOMUNA SHITE
OPSTINA STIMLJE/MUNICIPALITY OF SHITE

Drejtoria për Prokurim Publik

Akti i lëndës	Vendim për refuzim të kërkesës për rishqyrtim
Lënda	„Ndërtimi i shkollës fillore në Gjyrkoc,, 617-19-4374-5-2-1 Nr. i brendshëm 617 2019 048-521
Për	OE N.N.P. „CTA „ SH.P.K. Prishtinë z. Zija Morina
Përmes	Drejtorisë për Prokurim Publik
Nga	Muhadin Halili , Drejtor
Datë	02.08.2019

Në pajtim me nenin 108/A , zgjidhja preleminare e mosëmarrveshjeve, të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës , i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/-237, ligjin Nr.05/-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe në pajtim me legjislacionin sekondar F03 Rregullat për parashtrim të ankesave, Neni 8 vendim i Autoritetit Kontraktues .

Autoriteti kontraktues Komuna e Shtimës , Drejtoria për Prokurim Publik merr:

V E N D I M

Refuzohet, si e pa bazë kërkesa për rishqyrtim nga OE .. N.N.P., CTA „ SH.P.K. nga Prishtina lidhur me procedurën e prokurimit „Ndërtimi i shkollës fillore në Gjyrkoc,, Nr. i prokurimit 617-19-4374-1-2-1 Nr. i brendshëm 617-2019-048-521 të dorzuar me datë 30.07.2019.

Arsyetim

Autoriteti kontraktues Komuna e Shtimës , Drejtoria për Prokurim Publik , vleron se lënda „Ndërtimi i shkollës fillore në Gjyrkoc,, Nr. i prokurimit 617-19-4374-5-2-1 Nr. i brendshëm 617-2019-048-521 , është vlerësuar në pajtim me Ligjin nr. 04/L-042 për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës , i ndryshuar dhe i plotësuar me ligjin Nr. 04/-237, ligjin Nr.05/-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 dhe në pajtim me legjislacionin sekondar në fuqi.

OE N.N.P., CTA,, SH. P. K nga Prishtina është shpallur i pasuksesshëm nga Autoriteti Kontraktues Komuna e Shtimës , Drejtoria e Prokurimit Publik pasi që ka pas çmimin më të lartë.

Në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit , kriter për dhënjë të kontratës ka qenë Operatori i përgjegjshëm me çmim më i lirë .

Pretendimet se OE i propozuar për dhënjë të kontratës ,nuk i plotëson kriteret nuk qëndrojnë , pasi që komisioni i vlersimit me vemedje ka shqyrtuar të gjithë dokumentacionin e ofruar nga OE dhe ka rekomanduar se : Operatori Ekonomik , N.T.P., Ardhmëria ,, nga Shtimja i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosje të tenderit , dhe ka çmimin më të lirë.

Kundër këtij vendimi të Autoritetit Kontraktues ,OE mund ta paraqes ankesë pran OSHP-së brenda 10 ditëve nga vendimi i lëshuar prej Autoritetit Kontraktues.